

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
PML.-KZZ. Nr. 92/2013
Prishtinë
8 korrik 2013

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej
Gjyqtarit të EULEX-it Dr. Horst Proetel si kryetar i kolegjit,
Gjyqtarit të Gjykatës Supreme Avdi Dinaj dhe
Gjyqtarit të Gjykatës Supreme Salih Toplica si anëtarë të kolegjit,
në seancën e mbajtur më 8 korrik 2013, në lëndën penale kundër të pandehurit:

N. M.

I akuzuar sipas aktakuzës PPS. Nr. 114/2012, për kryerje të veprave penale të:

1. **Shpërdorimit të pozitës zyrtare ose të autorizimit në kundërshtim me nenin 339 paragrafin 1 dhe 3 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) dhe**
2. **Mbajtje të pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim me nenin 328 paragrafin 2 të KPK-së;**

Me aktgjykimin P. Nr. 346/12, të datës 23 maj 2013, (tash e tutje: 'aktgjykimi') Gjykata themelore në Pejë e ka dënuar të pandehurin për veprat penale për të cilat është akuzuar me dënim unik me pesë (5) vjet burgim, me gjobë prej dhjetëmijë (10,000) Euro dhe me ndalim të ushtrimit të funksioneve publike për tre (3) vjet pas lirimit të tij;

Duke vendosur mbi kërkesën në mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur më 10 qershor 2013 nga vetë i pandehur dhe mbi kërkesën e paraqitur më 17 qershor 2013 nga avokati mbrojtës në emër të të pandehurit kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit KP. 780/2013, të datës 1 qershor 2013, dhe aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë P. Nr. 346/2012, të datës 23 maj 2013, mbi caktimin e paraburgimit derisa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, dhe duke marrë parasysh edhe përgjigjen e Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPSHK-së) ndaj kërkesave të lartpërmendura të paraqitura më 28 qershor 2013,

Lëshon këtë:

AKTGJYKIM

N.M.
Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur më 10 qershor 2013 nga vetë i pandehur, dhe kërkesa e paraqitur më 17 qershor 2013 nga avokati mbrojtës në emër të të pandehurit kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit KP. 780/2013, të datës 1 qershor 2013, dhe aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë P. Nr. 346/2012, të datës 23 maj 2013, REFUZOHEN SI TË PABAZUARA.

ARSYETIMI

Historia e procedurës

Me aktvendimin e Prokurorit të Qarkut të EULEX-it në Prizren Rez. 01/11 (2011-XI-122), të ngritur më 10 shkurt 2012 në Gjykatën e Qarkut në Pejë, kanë filluar hetimet kundë. dhe tre të dyshuarve të tjerë.

N.M.
I pandehuri u arrestua më 2 prill 2012.

N.M.
Fillimisht u caktua masa e paraburgimit kundë në kohëzgjatje prej një (1) muaji me anë të aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë PP. 43/12, të datës 3 prill 2012.

Pas kësaj, paraburgimi u vazhdua disa herë në intervale kohore të përcaktuar me ligj, me aktvendime të kolegjit të tre gjyqtarëve dhe së fundmi me aktvendim të kryetarit të trupit gjykues të Gjykatës së Qarkut në Pejë.

Më 31 korrik 2012 Prokurorit i Qarkut i EULEX-it ngriti aktakuzën PPS. 114/2012, e cila u konfirmua me anë të aktvendimit për konfirmim të aktakuzës KA. 228/12, të datës 17 shtator 2012.

Shqyrtimi gjyqësor para Gjykatës së Qarkut në Pejë filloi më 3 dhjetor 2012.

Më 14 shkurt 2013 trupi gjykues si Gjykatës Themelore në Pejë me aktvendimin P. Nr. 346/2012 vendosi ta lejojë lirin me kusht të të pandehurit, me kusht që në Gjykatë të depozitohet dorëzania në shumë prej dhjetë mijë (10.000) eurosh dhe që i pandehuri t'i dorëzojnë dokumentet e tij të udhëtimit.

N.M.
Më 19 shkurt 2013, i pandehur pas përmbushjes së kushteve të përshkruara është liruar nga paraburgimi.

Pas ankesës së PSRK-së së paraqitur më 21 shkurt 2013 kundër aktvendimit të lartpërmendur, Gjykata e Apelit me aktvendimin e datës 7 mars 2013 ka rritur shumën e dorëzanisë dhe dy të bashkëpandehurit e tjerë prapë u arrestuan më

N.M.

15 mars 2013. Më 16 mars 2013 ^{N. M.} paraqiti depozitoi një shumë shtesë të dorëzarisë dhe u lirua. Dy të bashkëpandehurit e tjerë nuk depozituan shumën shtesë të dorëzarisë dhe mbetën në paraburgim.

Me aktgjykimin P. Nr. 346/12, të datës 23 maj 2013, (tash e tutje: 'aktgjykimi') Gjykata Themelore në Pejë e dënoi të pandehurin dhe dy të bashkëpandehurit e tjerë për veprat penale për të cilat ishin të akuzuar dhe të pandehuri ^{N. M.} e dënoi me dënim unik me pesë (5) vjet burgim, me dhjetëmijë (10,000) Euro gjobë dhe me ndalim të mbajtjes së pozitës publike për tre (3) vjet pas lirim të tij.

Me dy aktvendimin P. Nr. 346/12, të datës 23 maj 2013. kolegii i tre gjyqtarëve të kësaj gjykate caktoi masën e paraburgimit kundë ^{N. M.} deri sa aktgjykimi i përmendur të bëhet i formës së prerë.

Pas ankesës Gjykata e Apelit e vërtetoi aktvendimin e lartpërmendur.

Kërkesat për mbrojtje ^{N. M.} ligjshmerisë janë paraqitur më 10 qershor 2013 nga vetë i pandehur dhe më 17 qershor 2013 nga avokati mbrojtës në emër të të pandehurit kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit KP. 780/2013, të datës 1 qershor 2013, dhe aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë P. Nr. 346/2012, të datës 23 maj 2013.

Më 28 qershor 2013 ZPSHK-ja paraqiti përgjigjen ndaj kërkesave, me propozim që të refuzohen si të pabazuara dhe që aktvendimet e kundërshtuara të vërtetohen.

Parashtrësirat e palëve

a) Kërkesat ^{N. M.}

I pandehuri pohon se Gjykata e Apelit ka shkelur dispozitat e neneve 274, 275, 276 lidhur me nenin 391, paragrafin 1 dhe nenin 281 paragrafin 1 dhe 2 pikën (1) të KPK-së.

Ai pohon se Gjykata Themelore ka shkelur të drejtat e të pandehurit edhe pas shpalljes së aktgjyimit me aktvendimin e datës 27 maj 2013 për ndërprerjen e dorëzarisë dhe kthimin e shumës së dorëzarisë prej 25,000 Eurosh. Sipas mendimit të tij ka një kundërthënie në caktimin e paraburgimit dhe në të njëjtën kohë mbështetjen e urdhrin për dorëzani.

Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit kanë shkelur nenin 277 paragrafin 4 të Kodit (të vjetër) të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), i cili përcakton se "kur i pandehuri dënohet me burgim, dorëzania hiqet vetëm pasi ai të ketë filluar vuajtjen e dënimit".

Ai kërkon rishqyrtimin e lëndës, pasi thekson se ka kaluar tanimë një (1) vit në paraburgim, fakt që e zvogëlon rrezikun e arratisjes. Në krahasim me rastet e tjera, të pandehurit e tjerë me dënime më të rënda janë lëshuar për mbrojtje të vetes në liri.

Pohimi se ai ka mjete të mjaftueshme financiare dhe kontakte jashtë vendit është vetëm supozim i pabazë.

Në fund parashtrohet se Kryeprokurori i Apelit, Z A.L. është dashur të përjashtohet nga procedura ankimore pasi që ishte dëgjuar si dëshmitar në këtë lëndë.

Ai propozon të ndryshohet vendimi i formës së prerë i Gjykatës së Apelit dhe të confirmohet shkelja e ligjit ose që lënda të kthehet për rivendosje.

b) Kërkesa e avokatit mbrojtës: B.T.

Avokati mbrojtës B.T. pohon se në aktvendimin e Gjykatës Themelore ka kundërshtime dhe mospërputhje kur flet për 'Gjykatën e Qarkut' në vend të Gjykatës Themelore. Po ashtu gabimisht e citon ligjin e vjetër të procedurës, i cili nuk ka qenë më në fuqi në kohën e marrjes së aktvendimit. Aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë në faqen e fundit e citon nenin 281 paragrafin 1 nën-paragrafin 2 pikat ii) dhe iii) të KPPK-së, që i referohen arsyeve për të besuar se i pandehuri do ta pengojë zhvillimin e procedurës penale dhe rrezikut të përsëritjes së veprës penale, gjersa në vende të tjera aktvendimi qartazi mohon ekzistimin e këtyre dy kushteve.

Ai potencon se caktimi i masës së paraburgimit pasi gjykata e shkallës së parë e kishte shpallur të mbrojturin e tij fajtor dhe e kishte dënuar me pesë (5) vjet burgim është në kundërshtim me praktikën e zakonshme në gjykatat e Kosovës. Nuk ekzistojnë rrethana të veçanta lidhur me të mbrojturin e tij që do të mund ta mbështeste këtë masë pasi ai iu kishte përgjigjur të gjitha urdhrave dhe ftesave gjyqësore gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Kërkesa kundërshton se gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kundërshtim me ligjin kur e ka lënë masën e dorëzimit në fuqi deri më 27 maj 2013, kur gjykata mori vendim ta kthejë shumën e dorëzimit, pas caktimit të masës së paraburgimit.

Mbrojtja po ashtu argumenton se të dy aktvendimet e kundërshtuara nuk e kanë marrë parasysh sa duhet faktin se i pandehuri duhet të kujdeset për anëtarët e familjes së tij të sëmurë.

Përveç kësaj, avokati mbrojtës kundërshton se Gjykata Themelore në aktgjykim ka zbatuar dispozitën e gabuar të ligjit penal në dëm të klientit të tij kur është dashur ta zbatojë dispozitën më të favorshme.

Po ashtu pohohet se Gjykata e Apelit nuk është marrë realisht me argumentet e paraqitura në shkresën e Apelit kundër aktvendimit të shkallës së parë.

Avokati mbrojtës propozon të anulohen të dy aktvendimet e kundërshtuara, të ndërpritet paraburgimi dhe që klienti i tij të lirohet me kthimin e shumës së dorëzimit të caktuar më parë.

c) Përgjigja e ZPSHK-së

ZPSHK-ja i refuzon argumentet përkitazi me pezullimin e dorëzimit pasi që aktvendimi i datës 27 maj 2013 nuk i nënshtrohet këtij mjete ligjor. Kryeprokurori i Apelit, Z B.T. nuk ishte i përfshirë në procedurë ankimore. Gjykata e Apelit në aktvendimin e saj i ka adresuar të gjitha argumentet e ngritura në ankesën e

mbrojtjes kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë. Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë vetëm janë përsëritje e argumenteve të cilat tanimë janë marrë parasysh në procedurë ankimore.

Sa i përket rrezikut të pengimit të procedurës penale, që aktvendimet e kundërshtuar e mohojnë, ZPSHK-ja përshkruan një incident ku vetura e dëshmitari kishte shpërthyer para shtëpisë së tij më 23 qershor 2013. Edhe pse procedura penale në shkallë të parë kishte përfunduar në atë kohë, ky incidenti mund ta ndryshojë vlerësimin e këtij kushti. P.N.

ZPSHK-ja nuk gjen asnjë arsye për ta ndryshuar aktvendimin e Gjykatës së Apelit dhe propozon që kërkesat të refuzohen si të pabazuara dhe aktvendimet e kundërshtuara të vërtetohen.

Gjetjet

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton si në vijim:

Kërkesat janë të pranueshme por të pabazuara.

Kërkesat janë parashtruar me kohë dhe nga personat e autorizuar, në përputhje me nenin 433 paragrafin 1 të KPK-së. Neni 432, paragrafi 4 i KPPK-së parasheh se ankesë kundër vendimit për caktimin ose vazhdimin e masës së paraburgimit edhe pse aktgjykimi nuk është i formës së prerë.

Niveli i dyshimit të bazuar që kërkohet me nenin 187 paragrafin 1.1. të KPK-së pas aktgjykimit me të cilin të pandehurit janë dënuar, duket se është përmbushur.

Gjykata Supreme e refuzon kundërshtimin se ndërprerja e dorëzarisë menjëherë pasi është shqiptuar masa e paraburgimit e shkel ligjin. Nga aktvendimi i kundërshtuar i Gjykatës Themelore në Pejë, i datës 23 maj 2013, është shumë e qartë se gjykata pas aktgjykimit dënues ka bërë një vlerësim të ri të rrethanave për përcaktimin e rrezikut nga neni 187 paragrafi 1.2. i KPK-së dhe se masa e caktuar e paraburgimit zëvendëson çdo masë tjetër të caktuar më parë. Masa e datës 27 maj 2013 për kthimin e shumës së dorëzarisë është vetëm rrjedhojë logjike. Fakti se kjo ndodhi vetëm katër ditë pas aktvendimit të kontestuar nuk ka rëndësi dhe nuk ka pasur, dhe nuk ka ndikim në ligjshmërinë e paraburgimit të caktuar më 23 maj 2013.

I pandehuri është gabim kur propozon se neni 277 paragrafi 4 i KPPK-së (ekuivalent me nenin tani në fuqi 182 paragrafin 4 të KPK-së) e ndalon gjykatën që ta zëvendësojë masën e dorëzarisë me një masë alternative në rast se gjykata vlerëson se rrethanat kanë ndryshuar. Neni 182 paragrafi 1 i KPK-së qartë i jep gjykatës kompetencë për të caktuar paraburgimin pasi janë paraqitur arsye të reja ligjore.

Kolegjit nuk i lejohet t'i marrë parasysh pretendimet e paraqitura përkitazi me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale në aktgjykimin dënues, sipas nenit 432 paragrafit 1 të KPK-së. Mjeti i jashtëzakonshëm juridik i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet vetëm kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë. Kundërshtimi i përmendur i drejtohet vetëm aktgjykimit të shkallës së parë, i cili ende nuk është i formës së prerë dhe si i tillë nuk mund të shqyrtohet në këtë procedurë.

A.L.

Kolegji vëren se pretendimet se Kryeprokurori i Apelit, Z. [redacted] ishte i përfshirë në procedurë ankimore është i pahazë. I pandehuri nuk e ka vërtetuar se në cilën mënyrë Kryeprokurori i Apelit, Z. [redacted] kishte marrë pjesë në procedurë. Kolegji vërteton se në shkresat e lëndës nuk ekziston asnjë provë që vërteton pjesëmarrjen e personit të përmendur në procedurë ankimore.

Sa i përket citimit të gabuar në nenin 281 paragrafin 1 nën-paragrafin 2 pikat ii) dhe iii) të KPPK-së, Gjykata Supreme i referohet paragrafit të tretë nga fundi të aktvendimit të Gjykatës së Apelit, i cili nxjerr në pah se ky është vetëm një gabim i parëndësishëm në shkrim dhe e korrigjon citimin e gabuar.

Gjykata Supreme e Kosovës gjen se Gjykata e Apelit në aktvendimin e vet i ka adresuar në plotësi të gjitha argumentet e paraqitura në ankesën e mbrojtjes kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë. Kolegji pajtohet me përfundimet e aktvendimit të formës së prerë. Kërkesat nuk paraqesin asnjë argument të ri por i përsërisin pohimet e paraqitura në procedurën ankimore.

Mbrojtja argumenton se dy aktvendimet e mëparshme nuk e kanë marrë parasysh sa duhet faktin se i pandehuri duhet të kujdeset për anëtarët e familjes së tij të sëmurë. Kjo nuk qëndron sepse i pandehuri ka mundur ta mendojë këtë situatë para kryerjes së veprave penale për të cilat akuzohet. Aktvendimi i formës së prerë i Gjykatës së Apelit i ka marrë parasysh këto argumente dhe ka ardhur deri te përfundimi logjik dhe detyrues se këto argumente nuk mund ta ndryshojnë në masë të madhe vlerësimin për rrezikun e arratisjes.

Duke pasur parasysh atë që u tha më lart, në përputhje me nenin 437 të KPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur si në dispozitiv.

Krvetar i kolegjit:

Procesmbajtës:

Dr. Horst Proetel
Gjyqtar i EULEX-it

Holger Engelmann
Zyrtar ligjor i EULEX-it

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
PML.-KZZ. Nr. 92/2013
Prishtinë
8 korrik 2013